


REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 2833 rep, Nr. 296 kol.



KONTRATE SHITJE KUOTASH
TE KAPITALIT TE SHOQERISE
"ALB SHPRESA" SH.P.K

Ne Tirane, sot me daten 26/04/ 2001 (dymije e nje) ne zyren e noterise Tirane me adrese Rruga "Puntoret e Rilidjes" para meje Noter HALIL SINANI, u paraqiten personalsiht:

SHITESI:

Kadire Lala, e bija e **Shaqiri**, e dt. 10.09.1958, lindur ne Kukes e banuese ne Tirane me adrese Rruga "Irfan Tomaj" nr. 3/3, shk.2, ap.26, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

BLERES:

Mehdi Lala, i biri i **Subhan** i dt. 12.03.1961, lindur ne Kukes e banuese ne Paskuqan-Tirane, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Te cilet kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si me poshte vijon: -----
-Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ALB SHPRESA" sh.p.k, eshte e regjistruar si person juridik me vendim te gjykates se rrethit Tirane. Nr.2001, date 22.02.1994, me seli ne Tirane, me kapital themeltar 100.000 leke, me ortak te vetem themelues e administrator z. Asllan Lala. Me vendimin e gjykates se rrethit Tirane Nr.932, date 1603.2001 eshte celur deshmia e trashegimise e te ndjerit Asllan Lala. Me vendimin nr. 2001/2, date 09.04.2001 eshte bere depozitimi i vendimit te asamblese se ortakeve nr.2, date 05.04.2001 sipas te cilit kuotat e kapitalit te shoqerise "ALB SHPRSA" u kane kaluar ne rruge trashegimie: 1) Kadire Lala- 25%, 2) Have Bala (Lala)- 25 %, 3) Valmira Koldashi (Lala)- 25 % dhe 4) Endrit Lala -25 %. Me vendimin nr. 2001/3, date 19.04.2001 eshte bere depozitimi i vendimit te asamblese se ortakeve te dates 17.04.2001 sipas te cilit jane larguar nga shoqeria ortakët Have Bala (Lala), Valmira Koldashi (Lala) e Endrit Lala si dhe eshte bere kalimi i kuotave me ante te shitjes ne favor te Kadire Lala. **Ne kete menyre znj. Kadire Lala eshte ortak e vetme e shoqerise dhe zoteruese e 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise.**
Ortaku i vetem ka vendosur te pranoje si ortak te shoqerise z. Mehdi Lala dhe ky i fundit pranon te jete ortak i shoqerise. Gjithashtu, ortaku i shoqerise znj. Kadire Lala pranon te largohet nga shoqeria, duke ia shitur 100 % te kuotave qe ajo zoteron ne shoqeri z. Mehdi Lala, sipas kushteve te kesaj kontrate:
Shitesi Kadire Lala zoteruese e 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise, i shet kuotat e kapitalit qe zoteron ne shoqeri ne shumen prej 100.000 (njqind) leke, ndersa bleresi Mehdi Lala pranon blerjen e ketyre kuotave.
-Shitesi Kadire Lala deklaroi se eshte likujduar plotesisht ne shumen prej 100.000 leke, jashte zyres se noterise, leket pasi i kane numruar i kane gjetur te rregullta.
Me nenshkrimin e kesaj kontrate konform ligjes, shitesi Kadire Lala zhvishet nga kuotat e kapitalit qe zoteron ne shoqeri, si dhe nga cdo e drejte dhe detyrim, ndersa bleresi Mehdi Lala mbetet ortak i vetem i shoqerise dhe zoterues i 100 % te kuotave te kapitalit te shoqerise.

Kontrata redaktohet ne kater kopje origjinale konform rregullave dhe ligjes. Kjo kontrate bazohet ne dispozitat e nenit 705 e vijues te K.C, neni 47 i ligjit nr.7638, date 19.11.1992, si dhe statuti i shoqerise.

Paleve te sipershenuara pasi iu lexua kjo kontrate, iu spjegua permbajtja e saj, me vullnetin e tyre te lire e nenshkruajne rregullisht para meje dhe une noter e vertetoj sipas ligjit.



SHITESIT

1) Kadire LALA

Kadire Lala

PALET

BLERESI

Mehdi LALA

Mehdi Lala

NOTER
HALIL SINANI